



2025 SHKURT

Mbrojtja në një muaj





"MBUROJA E ARBRIT - 25"

Grup-Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë nisi stërvitjen "Mburoja e Arbrit - 25" që do të zhvillohet në rajone të ndryshme të vendit. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, theksoi angazhimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të qeverisë për përmirësimin e kushteve të punës dhe trajtimit të ushtarakëve, duke u përqendruar në rritjen e kapaciteteve operacionale, modernizimin e infrastrukturës dhe pajisjeve.

★★★★★

mod.gov.al

MM



HAPET THIRRJA PËR USHTARË DHE DETARË AKTIVË

Qendra e Personelit Rekrutimit ka nisur regjistrimin e kandidatëve për ushtarë dhe detarë aktivë, sipas kërkesave të Shtabit të Përgjithshëm të FA. Stërvitja Individuale Bazë do të zhvillohet nga 28 prilli deri më 4 korrik 2025, ndërsa afati për dorëzimin e dokumenteve është deri më 31 mars 2025.



mod.gov.al

MM

MINISTERIALI I NATO-s

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, mori pjesë në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s në Bruksel, ku kryefjala e diskutimeve ishte rritja e kontributit për paqen mes Rusisë dhe Ukrainës. Gjatë takimeve të ministrit Vengu me homologët nga SHBA, Franca, Italia, Kroacia dhe Hungaria, u theksua forcimi i bashkëpunimit ushtarak dhe avancimi i projekteve të përbashkëta në industrinë e mbrojtjes.

★★★★★



STËRVITJE E PËRBASHKËT NË DETIN EGJE

Anija "Butrinti" e Forcës Detare dhe ekuipazhi i saj, pjesë e misionit të NATO-s "Sea Guardian" në Detin Egje, realizuan një stërvitje të përbashkët me anijen gjermane FGS Planet A4137. Gjatë stërvitjes në ujërat ndërkombëtare, u testuan aftësitë operacionale dhe ndërveprimi me anijet aleate, duke respektuar standardet e NATO-s.

★★★★★

mod.gov.al

MM



FA PJESË E PANAIRIT "WORK & STUDY"

Akademia e Forcave të Armatosura dhe Qendra e Personel Rekrutimit, ishin pjesë e panairit dy ditor "Work & Study" në Pallatin e Kongreseve, Tiranë. Përmes këtij aktiviteti maturantët patën mundësi të njihen me programet e studimit bachelor dhe master në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Vetë zëvendësministrija e Mbrojtjes, Blerina Abrashda inkurajoi të rinjtë të bëhen pjesë e FA.

★★★★★

mod.gov.al



KOMANDANTI I KFOR NË TIRANË

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu priti në një takim, komandantin e misionit të KFOR, gjeneralmajor Enrico Barduani. Në qendër të diskutimeve ishin zhvillimet e fundit në Kosovë. Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes i shprehu komandantit të KFOR, mbështetjen e Shqipërisë për këtë mision, ku aktualisht kontribuojmë në mënyrë aktive.

★★★★★

mod.gov.al

MM



BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Gjatë muajit shkurt, Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu priti në zyrën e tij ambasadorët e Japonisë, Izraelit, Austrisë dhe Italisë, me të cilët diskutoi çështje të sigurisë dhe mbrojtjes me theksin te rritja e bashkëpunimit në këto fusha në të ardhmen.

★★★★★

mod.gov.al

MM



CEREMONIA NË FORCËN AJRORE

Katër ushtarakë, pilotë dhe teknikë të Forcës Ajrore u nderuan për kontributin e tyre në Forcat e Armatosura. Nënkolonel Faslli Spahiu, nënkolonel Pajtim Golemi, major Dhori Martiri dhe tekniku Bardhok Marku kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e hapësirës ajrore dhe sigurinë e Shqipërisë. Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, vlerësoi përkushtimin dhe sakrificat e tyre.

★★★★★

mod.gov.al

MM



ZV. MINISTRJA ABRAZHDA BASHKOHET ME EKIPIN E MBROJTJES

Znj. Blerina Abrazhda nisi detyrën në postin e zëvendësministres së Mbrojtjes. Me një karrierë të pasur ndërkombëtare, znj. Abrazhda sjell me vete eksperiencën dhe përkushtimin në shërbim të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare.

★★★★★

mod.gov.al

MM



KONTINGJENTI I FA NË MISIONIN E BE

Toga e Forcave të Armatosura e dislokuar në Bosnje dhe Hercegovinë në kuadër të misionit EUFOR është integruar plotësisht dhe në kohë rekord me Batalionin Multidimensional. 30 trupat shqiptare po kontribuojnë në rritjen e sigurisë jo vetëm në Bosnje dhe Hercegovinë, por në të gjithë rajonin. Kontingjenti shqiptar do të shërbejë në këtë mision për 6 muaj.

★★★★★

mod.gov.al

MM



30 KOMANDO I BASHKOHEN KFOR-IT

Në Regjimentin e Operacioneve Speciale (ROS) në Zall-Herr, u zhvillua ceremonia e përcjelljes së trupave të Batalionit Komando, i cili do të shërbejë në misionin “KFOR” në Pejë, Kosovë, si pjesë e NATO-s. 30 efektivë do të përfaqësojnë Forcat e Armatosura të Shqipërisë.





MBROJTJA NË PANAIRIN E ATHINËS

Në Athinë u mbajt panairi i punës, një nismë e qeverisë ku morën pjesë rreth 120 biznese shqiptare me oferta konkrete për t'u bërë thirrje shqiptarëve të rikthehen në vendin e tyre. Pjesë e panairit “Puno dhe jeto aty ku ke zemrën” ishte edhe Ministria e Mbrojtjes që u përfaqësua nga kompania “KAYO”.

★★★★★

mod.gov.al

MM